

**VENDIM**  
**Nr. 392, datë 28.5.2026**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 37, DATË 21.1.2026, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E ORGANIZIMIT TË BRENDSHËM TË ORGANEVE DREJTUESE E TË MËNYRËS SË FUNKSIONIMIT TË AGJENCISË KOMBËTARE TË EKONOMISË SË MBETJEVE SHA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 22, të ligjit nr. 57/2025, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr. 37, datë 21.1.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e organizimit të brendshëm të organeve drejtuese e të mënyrës së funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve sh.a.”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Kapitali fillestar për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve sh.a. është 100 000 000 (njëqind milionë) lekë.”.

2. Në pikën 12, pas fjalës “... objektivat ...” shtohen fjalët “... mbart të drejtat dhe detyrimet e AKEM-it ...”.

3. Në pikën 19, fjalët “... në vlerën 20 000 000 (njëzet milionë) lekë ...” zëvendësohen me “... në vlerën 100 000 000 (njëqind milionë) lekë ...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**